



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.51/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit [REDACTED] nga Gjakova, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 15.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.51/2026, e parashtruar nga [REDACTED] nga Komuna e Gjakovës, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 15.06.2026, ka pranuar ankesën ZP.Anr.51/2026, të dërguar me postë me datë 10.06.2026, parashtruar nga [REDACTED] nga Gjakova, me të cilën pretendohet se pas fillimit të numërimit të votave për kandidatë dhe pas përfundimit të numërimit të kutisë në Qendrën e Votimit 0206-SHML "Kadri Kusari", përkatësisht në vendvotimin 0206/02, nuk rezultojnë votat për kandidatin që është votuar nga ana ime dhe të tjerët, që nënkupton se ato vota nuk janë numëruar, përkatësisht për deputetet Fadil Demaku dhe Bekim Haxhiu. Për këtë ka kërkuar rinumërimin e kutisë së votimit 0206/02 me qëllim të mbrojtjes së votës së lirë. Tutje kanë theksuar së rezultatit e këtij vendvotimi e kanë marrë platformën e KQZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në përgjigjen në ankesë thekson se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), si dhe Procedurën Standarde të Veprimit për Aktivitetet në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të miratuar më 26.05.2026 me nr.01/989/2026, përcaktohen procedurat e detajuara që rregullojnë themelimin, funksionimin dhe menaxhimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN). Këto procedura përfshijnë gjithashtu mbikëqyrjen e procesit, pranimin dhe kontrollimin e materialit zgjedhor, verifikimin dhe numërimin e votave, si dhe trajtimin e ankesave që lidhen me procesin e punës në QKN. Bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Gjithashtu, sipas nenit 5, paragrafët 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet kryesore QKN-së përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 për Rezultatet Zgjedhore, neni 9, paragrafi 1, përcakton se: “Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim (VV), ose edhe përsëritjen e votimit në një vendvotim (VV) apo qendër votimi (QV). KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Gjakovës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: “Sa i përket ankesës nga pala në fjalë në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) gjithçka ka qenë transparente ku në ekipin e numërimit janë 4 anëtarë nga Subjekte të ndryshme numëruese, po ashtu procesi është vëzhguar përmes ekranit të televizionit nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe Demokracia në Veprim që ka qenë e pranishme kësaj radhe. Andaj në QKN - Gjakovë nuk kemi pasur vërejtje ose ankesë nga vëzhguesit e subjekteve politike që kanë qenë prezent. Andaj pretendimet lidhur me ankesën rreth vendvotimit në fjale nuk qëndrojnë. Procesi i numërimit në Gjakovë është përmbyllur me datën 11.06.2026 (e enjte) në ora 13:00h.” Sa i përket pretendimeve të palës ankuese, se ka votuar për disa kandidatë të caktuar, duhet theksuar se në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Për më tepër, ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, në fletëvotim nuk mund të identifikohet votuesi. Pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka dhënë prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e tij, duke përfshirë këtu: Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e ekipeve të numërimit në QKN etj. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ndërsa pretendimet e paraqitura në ankesë, për momentin, mbeten në nivel deklarativ, pasi nuk janë mbështetur me fakte dhe prova konkrete. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të komunës së Gjakovës, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë vëren se, ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga [REDAKTUAR] janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se ka votuar për kandidatët përmendur, ndërsa pretendimet e theksuara në ankesë më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete. Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja, vërehet se në vendvotimin përmendur nga ankuesi nuk ka pasur asnjë nga parregullsitë për të cilat pretendohen me ankesë.

Sa i përket pretendimit ankimor se ka votuar për disa kandidatë të caktuar të përmendur në ankesë, Paneli vlerëson se kuptim të nenit 4 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara dhe se publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në këtë kuptim, pretendimi se ka votuar kandidatë me emër e mbiemër nuk mund të vërtetohet, pasi vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, e rrjedhimisht nga kjo në fletëvotim nuk mund të identifikohet votuesi se kush ka votuar.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRUESA

ZP.Anr.51/2026 datë 15.06.2026

Kryesues i Panelit  
Hariz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.